

# AlbVET 3



Zbatuar nga:



Financuar nga:



Mbështetja zvicerane në Shqipëri kontribuon në përmirësimin e konkurrueshmërisë së ekonomisë, me një fokus të veçantë në arsimin dhe formimin profesional, për të përmirësuar aftësinë për punësim të grupeve të synuara që mbështeten edhe nga projekti AlbVET.

## NE KRIJOMË MUNDËSI

### **Mbështetja zvicerane për AFP-në në Shqipëri**

SDC ka mbështetur arsimin dhe formimin profesional në Shqipëri që prej vitit 1994, përmes projekteve të ndryshme zbatuar nga Swisscontact.

Projekti AlbVET ka filluar zbatimin në vitin 2007.

Nga ana operationale, projekti fokusohet në plotësimin, konsolidimin dhe qëndrueshmërinë e përqasjeve novatore të të nxënit, skemave të trajnimit, dhe cikleve të këshillimit për punësim.

Kapitalizimi i eksperiencës dhe dokumentimi i mësimëve të nxjerra gjatë mbështetjes së AFP-së, janë parësore për komponentin e manaxhimit të njohurive dhe komunikimit.

## AlbVET Faza 3

Korrik 2011 - Qershor 2014

Në **Reformën e Sistemeve Formale** projekti mbështet qeverinë për të përtërirë një profil të plotë profesional, atë të termo-hidraulikës, me përjasje të reja të të nxënimit bazuar në projekte në 10 shkolla në vend.

Projekti mbështet po ashtu zhvillimin dhe zbatimin e një tipi të ri trajnimi post - sekondar në teknologjinë e informacionit. Kjo është një nismë ndër-institucionale mes Universitetit të Durrësit dhe Shkollës “Beqir Çela”



*“Të nxënimit bazuar në projekte është një metodë e re për të cilën ne i kemi mirënjohës projektit AlbVET që e solli. Nxënësit tanë kanë shumë dëshirë të praktikojnë atë çka mësojnë në shkollë, ndaj edhe iu pëlqen pa masë puna në ishujt mësimorë që ka sjellë projekti. Po ashtu, puna në biznese që AlbVET na shtyn ta realizojmë me nxënësit në shumicën e orëve mësimorë të vitit të tretë, është shumë përfituese për ta dhe për biznesin. Ndaj ne ndjehemi të lumtur tek i shohim nxënësit të kualifikohen në mënyrë cilësore e të jenë të gatshëm për tregun e punës falë metodave të reja të sjella nga AlbVET”*

**Agim Jakupi, Drejtor i shkollës së mesme profesionale “Karl Gega” Tiranë**

# Partneritet për të Nxënët

## Si të arrihet në tregun e punës

Projekti promovon pjesëmarrjen e sektorit privat në ofrimin e Arsimit dhe Formimit Profesional si në sistemin formal, ashtu edhe në atë jo-formal.

Modele të suksesshme të Partneritetit për të Nxënët (PAFL) mbështeten në profilet e parukerisë dhe të prodhimeve të brumit në Fier, Sarandë dhe Durrës.

Nga ana tjetër, **Cikli i trajnimit për punësim** krijon bashkëpunim mes 4 organizatave jo-qeveritare lokale që zbatojnë projektin në dy nivele: trajnimin e këshilluesve dhe zbatimin e ciklit të këshillimit me përfituesit e drejtpërdrejtë.



4 organizata jo-qeveritare, partnere të projektit, punojnë drejtpërdrejt me përfitues që vijnë nga grupe në nevojë dhe i shoqërojnë ata në zhvillimin individual; që nga marrja e një profesioni e deri tek punësimi i tyre. Pjesë e rëndësishme e kësaj përqsasje është edhe bashkëpunimi me zyrat e punës dhe me sektorin privat, ku përfituesit bëjnë praktikën.

*“Është shumë e rëndësishme t’i shoqërojmë individët me këshillim deri në punësimin e tyre. Kjo është risi për ne dhe inkurajuese për përfituesit”*

**Ilir Kolla, Nndihmë për Fëmijët, Tiranë**



*“Periudha e praktikës dhe trajnimi në vendin e punës rrit shanset e punësimit për një nxënës të trajnuar cilësisht mirë”* - **David von Graffenried, ekspert ndërkombëtar.**

# Menaxhimi i Njohurive dhe Komunikimi

## AFP si çështje që i përket të gjithëve

Projekti AlbVET dokumenton, shpërndan dhe debaton mbi praktikën e suksesshme dhe mësimet e nxjerra nga mbështetja për AFP-në dhe mbi përjashtet që ofrojnë zgjidhje të mundshme për politikën kyçe të Arsimit dhe Formimit Profesional.

Projekti merr pjesë dhe kontribuon në platformat për shkëmbim, koordinim dhe bashkëpunim mes projektsh, donatorësh e autoritetesh kombëtare në këtë fushë.



AlbVET beson se Arsimi dhe Formimi Profesional është një rrugë mjaft tërheqëse dhe efikase për të hyrë në tregun e punës me aftësim dhe kualifikime cilësore.

Prandaj projekti mbështet pjesëmarrjen e shumë aktorëve, nxënësve dhe bizneseve në AFP, si edhe ndërgjegjësimin publik, promovimin dhe raportimin mediatik për këtë fushë të arsimit.

*“Është e rëndësishme që të ndajmë me palët e interesuara përvojat pozitive dhe mësimet e nxjerra mbi zgjedhjet për të mbushur boshllëkun e aftësive profesionale, përjashtet për të nxënë nëpërmjet praktikës, bashkëpunimin mes aktorëve dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në AFP” - Matthias Jäger, ekspert i AFP, përfaqësues i zyrës së Swisscontact në Shqipëri*

AFP duket interesant? Ashtu është. Projekti synon të konsolidojë përjashtet e reja në arsim, programet dhe skemat e partneritetit që rrisin shanset e punësimit për të rinjtë. Gjithashtu, projekti mbështet institucionet dhe organizatat partnere që t'i zbatojnë këto përjashtime në 7 mënyrë të qëndrueshme në programet dhe proceset e tyre të rregullta.

## **Partnerët e projektit**

- Ministria e Arsimit dhe e Shkencës
- Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

## **Përfituesit**

- 70 mësues dhe instruktorë nga shkollat profesionale në tre profile
- 15 këshillues dhe rreth 80 përfitues nga 4 OJF për zbatimin e ciklit të këshillimit drejt punësimit
- Instruktorë në sistemin jo-formal në profesionin e Parukerisë dhe Prodhimeve të Brumit.
- Drejtorë shkollash, përfaqësues të MASH dhe institucioneve në varësi, Shërbimit Kombëtar të Punësimit, organizatave të sektorit privat, etj.

**AlbVET** financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe zbatohet nga Swisscontact. Buxheti për fazën e 3-të është 2.7 milionë franga Zvicerane.

## **AlbVET**

Programi Zviceran i mbështetjes për AFP në Shqipëri  
Rr. Skënderbej, P.6. Ap 1/1 Tiranë. Po.BOX 2891  
Tel/fax (00355) 04 2231 850; info@albvet.al; www.albvet.al